



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri
Mbledhja nr. 60/2016
Prishtinë, më 14.6.2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Zhvillim Ekonomik,
Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Sasha Milosavljeviq, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: z. Avni Kastrati, zëvendësministër i Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Besfort Dreshaj, Rexhep Bllaca dhe Besim Tafa – MTI, Albert Krasniqi dhe Fjolla Uka – KDI, Dardan Abazi – INDEP, Dren Ajeti – GLPS dhe Mjellma Kadriu – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Donika Lushaku - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.6.2016;
3. Harmonizimi i qëndrimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur Amendamentin 32 të Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, i njoftoi anëtarët e Komisionit se rendin e ditës do ta shtojmë me një informatë lidhur me disa mendime dhe rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për pakon e projektligjeve të energjisë.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryetarit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.6.2016

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 07.6.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Harmonizimi i qëndrimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Amendamentin 32 të Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se siç e dini ne kemi pasur një aktivitet intenziv për t'i përgatitur amendamentet për këtë projektligj. Në ndërkohë e kemi parë edhe amendamentin e Komisionit për Buxhet, por në seancë plenare u bë debat për Amendamentin 32 dhe Kuvendi kërkoi që me Komisionin për Buxhet t'i harmonizojmë qëndrimet. Ne kemi zhvilluar konsultime me Komisionin për Buxhet dhe i kemi përafuar qëndrimet, mirëpo për shkak të rëndësisë së ligjit na duhen edhe disa konsultime shtesë lidhur me këtë çështje. Qëllimi është të arrijmë dy gjëra, që ky ligj të jetë efikas për procedura të përsheptuara për investitorë, por njëkohësisht të sigurojë transparencën në Kuvend lidhur me vendimet që merren për këtë ligj. Në këtë drejtim ligji është duke u harmonizuar me Komisionin për Buxhet dhe me aktorë të tjerë dhe më së largu deri në javën e ardhshme do ta kemi të harmonizuar edhe këtë nen. Kryetari propozoi që shqyrtimi i kësaj çështje të shtyhet për javën e ardhshme.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Shtyhet për javën e ardhme harmonizimi i qëndrimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me Amendamentin 32 të Projektligjit nr.05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës.

4. Njoftimi me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë lidhur me projektligjet e energjisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se kemi marrë një reagim nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (tutje Sekretariati) lidhur me projektligjet e energjisë. Sa i përket zgjedhjes së Bordit të KOSTT-it insistohet që të jetë plotësisht i ndarë nga gjenerimi edhe në aspektin e mënyrës së zgjedhjes së Bordit dhe procedurave për zgjedhjen e Bordit. Sekretariati konsideron se Qeveria fare nuk duhet të involvohet, por të gjitha procedurat duhet të zhvillohen nga Kuvendi për Bordin e KOSTT-it, dhe amendamenti përkatës në projektligjin për energjinë

elektrike të modifikohet në këtë drejtim. Te projektligji për Rregullatorin e Energjisë kërkohet që objektet e kultit të mos jenë pjesë e definicionit “konsumatorë familjar” dhe tarifat e konsumatorëve familjarë nuk duhet të aplikohen për ato duke mos reflektuar konsumin e tyre sepse ajo do të shkelte parimin e reflektimit të kostos. Sa i përket amendamentit të GP 6+, thonë se përmendja e etnitetit për emërimin e Bordit e shkelë pavarësinë politike. Edhe për amendamentin lidhur me mosmiratimin e raportit vjetor të Rregullatorit dy vjet radhazi Sekretariati thotë se kjo nuk duhet të jetë arsye për shkarkim të anëtarëve të Bordit. Edhe të projektligji për gazin natyror është më tepër një përkufizim dhe nuk është shumë problematik.

Raif Qela tha se vërejtjet që na i ka dhënë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë duhet t'i marrim shumë seriozisht, sepse janë vërejtje të institucionit i cili është kompetent të vërtetojë se janë transponuar apo jo direktivat nga pakoja e tretë e energjisë, si dhe është kompetent për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Nëse e rrezikojmë këtë e rrezikojmë tërë punën shumë të madhe që është bërë edhe prej Qeverisë edhe prej Kuvendit deri tani për të gjitha këto ligje që i kemi sjellë deri këtu pranë miratimit. Me rreziku që të shkojnë kot prej një mungese të vogël të vëmendjes sonë, pavarësisht se ata i kanë dhënë këto vërejtje pas afatit të duhur për t'i futur në amendamente, megjithatë mendoj se ne duhet të gjejmë zgjidhje ligjore. Ata konsiderojnë se të zgjedhën nga i njëjti organ Bordet edhe të Operatorit të transmetimit edhe të prodhuesit të energjisë është konflikt interesi si pasojë e kësaj ne jemi të detyruar që ta bëjmë në përputhje me atë që ka thënë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Besim Beqaj tha se jam pak i befashuar me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, sepse këto çështje i kemi diskutuar edhe me ta gjatë vizitës që ka pasur Sekretariati në Kosovë. Në këto tri kërkesa të Sekretariatit dy janë kërkesa të natyrës së mosharmonizimit me pakon e tretë të legjislacionit të BE-së, sa i përket energjisë dhe pjesa tjetër nuk është në kundërshtim, por thonë që nuk do të ishte mirë. Esenca e mendimit të tyre është që propozimet për anëtarë të bordit mos të vijnë prej Qeverisë, por të gjitha procedurat e përzgjedhjes të ndjekën nga Kuvendi. Për neve kjo nuk është ndonjë problem, potencoi z. Beqaj, edhe pse nxjerr probleme të natyrës administrative, procedurale, por nëse është në kundërshtim me pakon e tretë të energjisë edhe unë propozoj që ne ta kalojmë si proces të tillë dhe që të harmonizohemi, natyrisht do të duhej që të konsultonim edhe Qeverinë sepse ata janë sponsorizues të ligjeve. Çështja e dytë është çështja e kulteve fetare. Ne kemi pasur debat këtu a duhet të trajtohen ekonomi familjare apo nuk duhet? Ju e dini se qëndrimi im ka qenë që nuk do të duhej të trajtoheshin ekonomi familjare, ka pasur argumente të ndryshme, por edhe kjo nëse është në kundërshtim me rregullat e BE-së ne do të duhej ta aprovonim si të tillë, pavarësisht vullnetit tonë të mirë që kultet fetare t'i trajtojmë me prioritet. Kjo mund të rregullohet edhe me ligjin për të drejtat fetare. Pra, janë dy çështje të cilat e tangojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë harmonizimin me pakon e tretë të energjisë, potencoi z. Beqaj. Ndërsa pjesa e tretë lidhur me shkarkimin, z. Beqaj shprehu mendimin se nuk është në kundërshtim të drejtpërdrejtë së paku nga këndvështrimi që e kemi marrë ne që pas dy mosmiratimeve të raporteve vjetore atëherë të fillohen procedurat e përgjegjësisë. Besoj që kjo nuk do të duhej të ishte në kundërshtim, prandaj ndoshta do të duhej ta trajtonim pak më mirë sepse ne gjithmonë po dëshirojmë të rrisim përgjegjësinë në raport me Kuvendin, jo në raport me Qeverinë, nuk është çështje e pavarësisë, nuk humbet pavarësia sepse para Kuvendit të gjitha institucionet e pavarura kanë përgjegjësi për punët e tyre. Propozimi im është që këtë pjesën e tretë ta lëmë kështu, ndërsa dy amendamentet e para t'i adaptojmë si të

tilla dhe ta njoftojmë Kuvendin në seancë, sepse ne jemi në një situatë kur ligjet kanë shkuar në Kuvend dhe presim që ato të miratohen në lexim të dytë, theksoi në fund z. Beqaj.

Fatmir Rexhepi tha se kjo vonesë po na paraqet pengesa, sepse po e humbim hapin për mbylljen e procedurave për aprovimin e këtyre projektligjeve që kanë një rëndësi të veçantë për të cilat edhe si grupe të punës dhe si Komision kemi punuar mjaft shumë. Ne kemi konsultuar edhe më herët të gjitha këto institucione nga të cilat edhe këtë që sot ka bërë rekomandimet e veta. Atëherë të pajtohemi t' i përgjigjemi kërkesës së Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që të harmonizojmë amendamentet me ato standarde që kërkohen. Sa i përket zgjedhjes së Bordit nga Kuvendi, z. Rexhepi theksoi se në bazë të praktikave të zgjedhjes në Kuvend nuk është treguar ndonjë sukses i mirë, në kualitet nuk kemi me mund me ngritur diçka, por sido që të jetë po i përgjigjemi pozitivisht. Agjencitë

e pavarura duhet të japin llogari, duhet të gjendet forma që ato të japin përgjegjësi. Ne po i japim mandatin dhe autoritetin për me kryer një punë në fushën e caktuar të cilat kanë peshë të madhe në jetën ekonomike të vendit, por kur vjen koha në fund me raportuar atëherë cila është përgjegjësia e tyre, nuk aprovohet njëherë raporti, nuk aprovohet dy herë, nuk aprovohet tri herë dhe këtu kërkohet që kurrkush të mos merret në përgjegjësi. Duke i pasur parasysh këto specifika të veprimit tonë megjithatë ne po provojmë të shkojmë kah Evropa në kuptimin e integritit, por na duhet kohë, jemi larg me kërkesën e tyre, dhe nëse është pengesë atëherë t' i pranojmë rekomandimet e Sekretariatit, u shpreh në fund z. Rexhepi.

Blerim Grainca tha se në parim të gjithë po pajtohemi që prioritetet dhe qëllimet tona të afrohen me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Mirëpo, unë më shumë kam vërejtje procedurale se sa përmbajtjesore, sepse personalisht nuk jam i gatshëm me diskutuar për një letër që nuk e kemi parë ende. Ai pyeti se si do të jetë me procedura, a do të kthehet edhe njëherë kjo pako e projektligjeve në Komision apo do të japim rekomandimin tonë për Kuvend, duhet të sqarohet cila është procedura, e mos të ndodhë sikur ligji për investimet strategjike kur dy Komisionet ishin me qëndrime të pa harmonizuara.

Kryetari sqaroi se sot e morëm në shqyrtim për shkak të urgjencave dhe dëshirova me ju informuar. Natyrisht ne sot asgjë nuk do të provojmë pa e shkruar tekstin. Unë ju informova për shkresën dhe ne duhet të bëjmë zgjedhje, a ta trajtojmë këtë shkresë? Në qoftë se e trajtojmë vijnë amendamentet dhe teksti i spastruar me amendamente.

Raif Qela shprehu mendimin se pavarësisht se Sekretariati i Komunitetit të Energjisë e ka dërguar me vonesë procedurale, megjithatë për shkak të peshës jemi të detyruar ta trajtojmë. Përpara se ta dërgojmë në seancë të kemi si Komision qëndrim dhe seancës t'ia orientojmë punën se kah të shkojë, të shkojë në lexim të tretë apo t' i miratojë amendamentet ashtu siç i prezantojmë ne përpara seancës në mënyrë që si të tilla të kalojnë. Për vërejtjen e parë që është dhënë kemi mundësi ta trajtojmë në atë mënyrë që pjesën më të madhe të procedurës së konkursit t'ia lëmë Qeverisë, e tërë materialin pastaj t'ia dërgojë një Komisioni të përzgjedhur të Kuvendit dhe në këtë mënyrë thjeshtësohet edhe procedura.

Kryetari shtoi çështja është a mundemi ne me i korigjuar deri në seancë apo të kërkohet që këto ligje të shtyhen për javën tjetër eventualisht leximin e tretë? Përndryshe nuk ka ndonjë arsye që ne të ngutemi e të kalojmë diçka pa e analizuar. Kryetari Mustafa potencoi se ne, si

Komision i kemi tri mundësi që të marrim qëndrim: 1. Me u thënë që i keni dërguar me vonesë, edhe ne shkojmë me këtë ligj, eventualisht në procedura më tutje në qoftë se e shohim se janë në kundërshtim me aktet e pakos së tretë të energjisë, dhe nëse të gjitha vendet e tjera i kanë atëherë e përmirësojmë ligjin; 2. Varianti i dytë është që ne me i korrigjuar këto amendamente deri në seancë; dhe 3. Varianti i tretë është me kërkuar të hiqen prej rendit ditës, me u shty në javën tjetër edhe me i shikuar këto më ngadalë edhe me Qeverinë. Në fund z. Mustafa kërkoi nga deputetët të deklarohen për qëndrimin që do të mbahet.

Besim Beqaj sqaroi se ne para vetes kemi një situatë jonormale në kuptimin e procedimit të ligjeve. Të shohim nëse me të vërtetë është në kundërshtim me pakon e tretë, të bëjmë ndryshimet gjatë seancës, deri në seancë ta verifikojmë saktë a janë në kundërshtim me pakon e tretë të energjisë? Propozoj që stafi i Komisionit t'i bëjë si amendamente rekomandimet e Sekretariatit, nesër të konsultohemi me Ministrinë, dhe të enjten të takohemi para seancës dhe t'i miratojmë ato.

Raif Qela theksoi se lidhur me vërejtjen e parë, të projektligji për energji elektrike, te amendamenti 14, në vend të fjalës "Qeveria" të thuhet "Komisioni", dhe me këtë arrihet qëllimi. Në fund tha Sekretariati është shumë i qartë në rekomandimet e veta, ne duhet vetëm t'i vendosim në letër.

Kryetari potencoi se duhet të thirret edhe MZHE-ja e të shohim këtë situatë nëse mund ta tejkalojmë deri në seancë. Grupi punues të sqarojë me Sekretariatit dhe të adaptojë amendamentet nëse mundim deri të enjten, nëse nuk mundemi shkojmë në lexim të tretë.

Blerim Grainca duke iu referuar diskutimeve tha se atëherë do të duhej që nesër të kryhet dhe se a ka mundësi teknike që të kryhet deri në seancë.

Fatmir Rexhepi propozoi që sot menjëherë të takohet grupi punues dhe të ftohet edhe MZHE-ja dhe të zgjidhet kjo çështje.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Grupi punues dhe deputetët e tjerë të interesuar të Komisionit të mbajnë mbledhje sot që të shqyrtojnë rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë lidhur me pakon e projektligjeve të energjisë, dhe të dilet me propozim- amendamente.

5. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa